



Kreditimi Rural i Kosovës, me seli në Prishtinë, është institucion Mikrofinanciar. Bazuar në rregullën e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës mbi Auditimin e Jashtëm të Institucioneve Mikrofinanciare, Kreditimi Rural i Kosovës duhet të auditoj pasqyrat e saj financiare nga auditorë apo firmë auditimi të licencuar në Kosovë.

Prandaj Kreditimi Rural i Kosovës LLC, publikon këtë:

FTESE PËR PARAQITJEN E OFERTAVE

Ftojme kompanitë audituese të licencuara nga Këshilli i Kosovës për raportim Financiar (KKRF), që të paraqesin ofertat e tyre për :

-Auditimin e pasqyrave financiare të Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) SHPK për vitin 2026, sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS).

Afati i përfundimit të auditimit të pasqyrave financiare 31.03.2027.

Ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e ndarë për auditimin e pasqyrave financiare të KRK-së për vitin 2026 sipas IFRS, dhe një ofertë të ndarë për auditimin e pasqyrave financiare të KRK-së për vitin 2026 në pajtueshmeri me rregullat e BQK-se (e cila mund të kërkohej të hartohet në rast se ka diferenca materiale në mes të IFRS dhe rregullave të BQK-se).

Ofertat e paraqitura, përveq tjerash, duhet të përmbajnë:

- Licencën nga Këshilli i Kosovës për raportim financiar
- Certifikatën nga Ministria për Ekonomi dhe Financa për licencimin e kompanisë audituese
- Certifikatën e regjistrimit në ARBK
- Përvojat në auditimin e bankave dhe institucioneve tjera financiare në Kosovë,
- Rekapitullimin lidhur me numrin e stafit dhe përvojat e tyre,
- Specifikimin e mbështetjes së disponueshme nga partnerët e jashtëm apo degët simotra,
- Raporti duhet të ofrohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze
- Ofertën financiare

Pranimi i ofertave bëhet deri më dt.31.03.2026.

Nëse keni nevojë për ndonjë informacion lidhur me përgaditjen e ofertës, ju lutemi të drejtoheni me kërkesë në formë të shkruar.

Kompanitë e interesuara mund t'i dërgojnë ofertat e tyre në email adresën krk_imf@krk-ks.com, apo direkt në zyrën e KRK, Rruga: Behije Dashi, Objekti D pn, Prishtinë.